

Aventurë franceze në Shqipërinë e vitit '64

Mer, 31 Tetor 2007

Alma Mile

Pas 42 vjetësh nga botimi, u promovua dje libri me përshtypje udhëtimi i francezit Albert Mayzie. I pranishëm në promovim i biri arkeolog, Alain Mayzie

I kishte parë brigjet shqiptare prej së largu dhe vendosi t'i vizitonte me çdo kusht. I bëri përshtypje gjuha e çuditshme me 36 gërma, që u shkante aq për shtat shqiptarëve, fytyrat e qeshura të fshatarëve në fusha. Nuk e kuptonte se përse në faqe malesh e fasada pallatesh shkruheshin parulla të tipit “Lavdi PPSH-së!”. I dukej surreal fakti që në rubineta dilte ujë me rërë. Ishte viti 1964, kur kameramani aventurier Albert Mayzier erdhi në Shqipëri bashkë me gruan dhe 9 fëmijët e tij. Kishte vizituar kaq shumë vende dhe Shqipëria i mbetej për të plotësuar pazëllin shumëngjyrësh botëror. Një vit më vonë botoi një libër të titulluar “Aventurë në Shqipëri 1964”, që për shkaqe që dihen nuk hyri në Shqipëri. Do të duhej të kalonin plot 42 vjet që ky libër për Shqipërinë të lexohej edhe nga shqiptarët. Me këtë rast u zhvillua një ceremoni promovimi, ku morri pjesë i nënti pinjoll i Mayzieve, Alain Mayzie. “Im atë ishte një personalitet tepër origjinal, një aventurier i madh, pjesë e Rezistencës franceze gjatë Luftës së Dytë Botërore, por dhe një kameraman i madh. Një ditë pati një ide madhështore. Me kamerën në krah u nis për një udhëtim aventuror bashkë me gruan dhe nëntë fëmijët e tij. Falë tij ne njohim gjithë kontinentet”, - tregon Alain, i cili vazhdoi udhëtimin e të atit me familjen e tij. “Babai im ëndërronte të vinte në Shqipëri që në vitin 1960, sepse kishte parë brigjet shqiptare me kajak nga deti Adriatik. Duke e parë që larg tha: unë dua ta shoh këtë vend. Pyetjes se përse duhet të shkojmë në Shqipëri ai na u përgjigj se jemi kushërinj. Ne jemi keltë, ata janë ilirë, pra i bie të jemi kushërinj. Përfituam nga një hapje e vogël në vitin 1964. Kaluam 60 ditë në Shqipëri dhe kjo kohë e mrekullueshme ka mbetur e gdhendur në kujtimet e familjes sime deri më sot”, - vazhdon Mayzie, i cili në kohën kur vizitoi Shqipërinë ishte vetëm 14 vjeç. Sipas tij, pas kthimit në Francë, i ati realizoi një film me metrazh të gjatë që e prezantoi në të gjitha vendet frankofone. U shfaq në shumë konferenca dhe u bë një pikë referimi për mijëra të huaj, që nuk dinin asgjë për vendin e izoluar. Libri i promovuar dje është pikërisht rrëfimi i udhëtimit 60-ditor. “Shqipëria e vitit 1964, parë nga francezët që udhëtonin shumë”, - përkufizon Alain, ndërsa kujton fytyrat e qeshura të fshatarëve, arkeologëve, miqve të rinj, që i pritën me shumë dashuri. Dhe në shumë pjesë të librit autori nuk lë pa përmendur mikpritjen e shqiptarëve. “Rrok Zojsi na kishte rregulluar të vizitonim një shtëpi të vjetër tiranase, që ishte duke u shndërruar në një “monument kulture”. Kjo banesë ishte ende e banuar dhe ne u pritëm shumë mirë nga pronarët. Aty gjetëm me ndryshim fare të vogël stilin që e kishim parë edhe në Shkodër. Gjithçka ishte sistemuar shumë mirë, thuajse në nënyrë të përsosur. E kjo paraqitje e kujdesshme përputhej me zakonet



shqiptare dhe nuk ishte një mizanskenë për turistët”, - shkruhet në libër. Por Mayzie nuk mund të mos vinte në dukje edhe problemet e Shqipërisë aso kohe. “Ne shqiptarët duke lexuar këtë libër kuptojmë më mirë shpirtin tonë, kuptojmë Shqipërinë e asaj kohe. Përshkruhen cilësitë që përmend Bajroni. Por ka edhe pjesë që nuk do të na pëlqejnë. Të metat i dimë, i kritikojmë vetë, por nuk na pëlqen kur na i thonë të tjerët”, - thotë Neritan Ceka, një nga lexuesit e hershëm të librit dhe shoqëruesi i familes Mayzie nëpër sitet arkeologjike gjatë vizitës së vitit 1964. “Libri u shkrua nga një mik që e donte Shqipërinë, kështu që edhe kritikata janë konstruktive. Kur ky libër u promovua në vitin 1965, Radio Tirana bëri një emision special. Dhe në këtë emision thuhej : “Një mik i Shqipërisë që bën kritika për Shqipërinë”. Mbjaj mend që im atë thoshte që në rubinetat e republikave Socialiste, del ujë me rërë. Ndaj edhe ky libër nuk u shpërnda në Shqipëri”, - kujton Alain Mayzie. Sot ai është arkeolog dhe thotë që nxitjen e mori pikërisht në moshën 14- vjeçare, kur zbuloi Durrësin, Shkodrën, Apolloninë, Butrintin, prej tregimeve të 23-vjeçarit Neritan Ceka, që të motrat e quanin mes tyre Apollon. “Pas 20 vjetësh nga vizita e ‘64-ës vjen në vitin 1986, për të mbrojtur diplomën e tij për arkeologjinë në Shqipëri, për Apoloninë. U vlerësua nga një komision që përbëhej atëherë nga Hasan Ceka, Aleksandra Mano, Skënder Anamali dhe Frano Prendi. Mayzie ishte i vetmi student i huaj nga Perëndimi, që vinte të mbronte diplomën e tij në një vend komunist siç ishte Shqipëria e asaj kohe”, - thotë Ceka.

Nga libri

Parulla dhe publicitet

“Gjatë dy muajve, ne nuk do të mund të gjenim vend shqiptar, anë rruge, plazh, mur kishe, mal shkëmbor, ndërtesë zyrtare, kantier, uzinë, dyqan, pa njërën nga këto mbishkrime, Rroftë! Lavdi PPSH! Mbishkrime të mërzitshme që i thurin lavdi drejtuesve të sotëm. Lexuesit kritikë do të më kundërshtonin duke më thënë se padyshim publiciteti për cigaret apo sutjenat, prishin po ashtu shumë peizazhe perëndimore, dhe unë do t’iu jepja atyre shumë të drejtë. Si anëtar “veteran” i “Touring Club” në Francë, unë dua t’ju pohoj këtu kundërshtimin deri në fund për gjithçka që ndot peizazhin dhe bërtas me zë shumë të fortë: “Poshtë publiciteti në natyrë”. Kjo vlen njëlloj edhe kur ai mburr të përbrendshme, apo edhe një regjim politik, dhe kur ky i fundit ka ndërmarrë një detyrë pastrimi.

Një alfabet i çuditshëm

Kontakti i parë që mjaft shkurajues. Guida e shkruar me pasion dhe hollësi, ishte hartuar me një fëngjishte shumë të keqe, saqë mbasi kisha lexuar disa faqe, koka ime ishte gati të shpërthente dhe nervat më ishin acaruar.

Le të përcaktojmë së pari një pikë të caktuar që do t’ju tregojë shpirtin pak të torturuar të miqve të mij të mirë shqiptarë. Alfabeti i tyre i sajuar i tëri në vitin 1908, në Kongresin e Manastirit kishte 36 gërma. Unë mësova se U-ja ishte e ngjashme e EU-në frënge, si te fjala “Poumon”, gjë që akoma se kam kuptuar mirë dhe se ky alfabet iu lejonte të gjithë gurmazeve shqiptare të shpreheshin lirisht, dhe se fjalët shqipe e kishin prejardhjen nga gjuhët e vjetra iliriane, thrake.